

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje full risk e pajisjeve mjekesore, CT Scanner dhe Mamografi” / REF-75454-07-19-2023 (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 mujor) i ndare ne dy lote perkatesisht

Lot. 1 – “Mirembajtje full risk e pajisjes mjekesore, CT Scanner” / REF-75457-07-19-2023

Lot. 2 - “Mirembajtje full risk e pajisjes mjekesore Mamografi” / REF-75459-07-19-2023

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50421000-2 - Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore

VLERA E FONDIT LIMIT:

fondi limit / vlera e pritshme e kontratave total per te dy lotet : **3 581 599.92** (tre milion e peseqind e tetedhete e nje mije e peseqind e nentedhete e nente pike nentedhete e dy) leke **pa TVSH perkatesisht** :

“Mirembajtje full risk e pajisjeve mjekesore, CT Scanner dhe Mamografi”. (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 mujor) i ndare ne dy lote perkatesisht

Fondi limit / vlera e pritshme e kontratave per **Lot. 1 – “Mirembajtje full risk e pajisjes mjekesore, CT Scanner”** : **2 601 600** (dy milion e gjashtëqind e nje mije e gjashtëqind) lekë pa TVSH;

Fondi limit / vlera e pritshme e kontratave per **Lot. 2 - “Mirembajtje full risk e pajisjes mjekesore Mamografi”** : **979 999.92** (nenteqind e shtatedhete e nente mije e nenteqind e nentedhete e nente pike nentedhete e dy) lekë pa TVSH.

Burimi i Financimit : Buxheti i Shtetit (Kjo procedure eshte deleguar per tu kryer nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale me shkrese me shkrese nr.541/14, date 12.06.2023 administruar prane Spitalit rajonal fier me nr.2090, date 13.06.2023

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Spitali Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Objekti i kontrates

“Mirembajtje full risk e pajisjeve mjekesore, CT Scanner dhe Mamografi”. (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomikë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 mujor) i ndare ne dy lote perkatesisht

Lot. 1 – “Mirembajtje full risk e pajisjes mjekesore, CT Scanner”

Lot. 2 - “Mirembajtje full risk e pajisjes mjekesore Mamografi”.

Kontrata është ndare në dy lote konform të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duke marrë parasysh natyrën e aparaturave të cilat janë objekt i këtij prokurimi.

Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 49 dhe 52 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nenet 55; 59; 60 pika 1 germa ç; 61; 62; 63 pika 1; 64 pika 1 germa a

1.Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër të tilla si shërbimi i tipit “full risk”, specifikimet e sakta teknike si dhe kushtet e kontratës.

2. Nga eksperiencat e mëparshme të prokurimit të këtij objekti nga MSHMS, ka rezultuar se numri i OE pjesëmarrës ka qenë i kufizuar vetëm sipas prodhuesit të pajisjeve, pra vetëm nga një Operator Ekonomik për secilin prodhues.

3. Ofrimi i shërbimit nga operatorë të ndryshëm ekonomikë është i pamundur për këtë lloj kontrate për vetë natyrën e saj “full risk” si dhe për arsye teknike organizative, pasi do të shoqërohej me mospërputhjen e artikujve të ofruar apo pjesëve të tyre me pajisjet ekzistuese si dhe do të pengonte përdorimin sistematik të pajisjeve dhe do të conte drejt deteriorimit të tyre.

4.Lidhja e MK me një OE , do të shoqërohej me mireorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e pjesëve të kembimit dhe furnizimet e tyre në kohë. Gjithashtu siguria për kontratat që parashikohet të lidhen i jep mundësi OE të mos i ngrejë kostot e ofertes.

5.Duke qenë se Shqipëria është një treg i vogël dhe shërbimet objekt i kësaj MK janë shumë komplekse dhe të lidhura me pjesë të kembimit që janë mallra importi pra nuk ka prodhim vendas , me qëllim garantimin e furnizimeve në afatet kohore të përcaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave të AK dhe duke garantuar mbulimin me këto shërbime pra dhe funksionim të pa ndërprerje të punës së pajisjeve diagnostikuese.

6. Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE, pra rrjedhimisht ku jo të gjitha kushtet do të ishin të përcaktuara, do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me vonesa në asistencën kryesisht korrektive gjatë ofrimit të shërbimit. Kjo vonese do të variojë në varesi të defektit me disa dite deri në disa javë në varesi të pjesës së kembimit e cila mund të disponohet nga operatori në Shqipëri ose duhet porositur në vendin e prodhimit çka do shkaktonte zgjatjen e rrjedhës së pritjes së pacientëve për pajisje diagnostikuese objekt të këtyre kontratave vonesa të cilat mund të jenë jetike pasi në disa forma diagnozash vonesa e diagnostikimit dhe si rrjedhim vonesa e fillimit të trajtimit si në rastet e semundjeve kanceroze, kardiake etj. të cilat rezultojnë fatale për jetën e pacientëve

7. Gjithashtu kjo procedure është zgjedhur duke patur parasysh dhe eksperiencën e viteve të mëparshme ku marrëveshja kuadër me një OE ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara ka sjellë stabilitet lidhur me mirëmbajtjen e aparaturave dhe mirëfunksionimin e tyre duke mos sjellë pengesa në ofrimin e shërbimit në kohë kundrejt pacientëve.

TE NJEJTA PËR TE DY LOTET

1- Kriteri i përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar bazuar në nenin 87, pika 1, 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 45 pika 1,2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Fondit limit / vlera e pritshme e kontratave total për të dy lotet : 3 581 599.92 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e nentëdhjetë e nente pike nentëdhjetë e dy) leke **pa TVSH**

Fondi limit është përlogaritur bazuar në V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 76 në titullin “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1. Në përlogaritjen

e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

germa b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;

referuar ne rastin konkret Autoriteti Kontraktor ne perlllogaritjen e fondit limit eshte bazuar cmimet mesatare te tregut pasqyruar ne process verbalin nr.2325/1.prot date 29.06.2023 te Grupit te punes per perlllogaritjen e fondit limit, process verbalin e komisionit te testimit te tregut nr.2172.prot date 20.06.2023 si dhe bazuar ne kerkesen nr.2417.prot date 04.07.2023 te Pergjegjeses se Sektorit te Planifikimit dhe Prokurimit

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

d. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“ i ndryshuar, ku eshte e parashikuar se:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit **të lotit ku ofertohet / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurren.**

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do të aplikohet mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit të cituar me lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/c dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/c

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës,* vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2022, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2023.

Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Neni 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" pika 3 dhe pika 9

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së lotit ku ofertohet / shumatorës së loteve për të cilat ofertuesi konkurren.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Permbushja e njerit prej kriterëve të mesipërme e ben oferten te vlefshme

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera do te aplikohet mbi vlerën e pritshme te kontratave qe mund te lidhen

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" nenit 77 pika 4 ku percaktohet se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; neni 41 pika 3 ku citohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës" dhe neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara." dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

Ne baze te VKM-se nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, neni 41 pika 3 ku citohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës" dhe neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara." Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, dhe vlera e kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri ka për qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK pasi në rastin aktual kemi të bëjmë me aparatura mjekësore të një natyre të veçantë

Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar Neni 42 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" pika 3 dhe pika 9

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të ketë punonjës të specializuar / kualifikuar minimalisht 1 (një) inxhinierë / specialist **te trajnuar** për mirëmbajtjen e aparaturave objekt të këtij prokurimi me profil inxhinier biomjekësor/elektronik/elektrik/mekatronik/mekanik ose degë të tjera të ngjashme me to.

- ✓ Për këtë OE duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese për secilin nga stafi më sipër:
 - CV-në e specialistit/ve;
 - Çertifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre çertifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,;
 - Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
 - Listëpagesa ku të figurojë emri i inxhinierit/specialistit të deklaruar minimalisht për muajin **MAJ 2023**.

OSE

- ✓ Me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes, për të dhënë mundësi cdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mësipërm jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi me kontratë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Shënim:

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

*Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin**".*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet se 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" I ndryshuar ku përcaktohet se b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: është kërkuar 1 inxhinier/specialist i trajnuar për mirëmbajtjen e aparaturave objekt të këtij prokurimi me profil inxhinier biomjekësor/elektronik/elektrik/mekatronik/mekanik ose degë të tjera të ngjashme me to, është kërkuar inxhinier për vetë specifikën që kanë këto aparatura pasi kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ekzaminimin dhe përcaktimin e diagnozës së pacientit. Kjo pikë është lënë gjithashtu me alternative në mënyrë që të rrisë numrin e OE të interesuar për këtë procedurë.

2.3.3. Një deklaratë që merr përsipër kryerjen e mirëmbajtjes të tipit Full Risk sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe specifikimeve teknike.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera percaktohet se . 6. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.ne rastin actual deklarata sherben si tregues I kapaciteteve teknike dhe profesionale te OE te interesuar per kete procedure prokurimi.*

2.3.4. Nje deklarate që merr përsipër zevendesimin e pjesëve te këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe ne përputhje me ato te përdorura fillimisht (te garantuara nepermjet certifikimit CE ose FDA) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne funksion te cilesise së mallit te ofruar ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit ; piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit; nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar ku percaktohet se 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.ne rastin actual deklarata sherben si tregues I kapaciteteve teknike dhe profesionale te OE te interesuar per kete procedure prokurimi. Ky kriter eshte vendosur per arsye se diektiva CE ose FDA (SHBA) jep kërkesat thelbësore që janë të zbatueshme për instrumentet, aparateve dhe pajisjeve, materialeve ose artikujve të tjerë që përdoren nga njerëzit me qëllim percaktimin e Diagnozes, parandalimit, monitorimit, kurimit apo lehtësimit zbutjes së sëmundjes, Diagnozes, monitorimit, kurimit apo lehtësimit, zbutjes apo kompensimit për një lëndim apo difekt, Hulumtimin, zëvendësim apo modifikim të anatomisë apo të procesit fiziologjik ne funksion te dhenies se nje sherbimi sa me cilesor ne funksion te jetes se pacientit.Gjithashtu ky kriter eshte hartuar ne baze te rekomandimeve te Njesise se monitorimit prane APP-se ne procedurat e mëparshme te kryera nga AK.**

Ky kriter gjën mbështetje dhe ne nenin 17 të Ligjit nr.89/2014 “Për pajisjet mjekësore” si dhe të nenit 7 të ligjit 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 89/2014”, krahas kërkesës së miratimit/certifikimit CE, AK lejon edhe mundësinë e paraqitjes së certifikatës FDA, si një dokument, i cili konfirmon konformitetin e pajisjeve/artikujve mjekësore objekt prokurimi, me qëllim hartimin e kriterit në konformitet me dispozitat në fuqi, si dhe moskufizimin e OE, të cilët tregtojnë dhe paraqesin pajisje dhe artikuj mjekësore vetëm me certifikimin FDA dhe jo me certifikimin CE

2.3.5. Një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera percaktohet se . 6. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.ne rastin actual deklarata sherben si tregues i kapaciteteve teknike dhe profesionale te OE te interesuar per kete procedure prokurimi dhe sherben per te percaktuar grafikun e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve ne menyre qe te mos krijoje konfuzion ne zbatimin e kontrates.*

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e pajisjeve qe do te mirembaje ose nga Distributor të Autorizuar. Ne rastin e distributorit te autorizuar te provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera

percaktohet se . 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontrates pra te garancise se furnizimit te pjesëve te nderrimit qe do te nevojiten per zbatimin e kontrates objekt prokurimi, pasi ne rastin aktual kemi te bejme me aparatura specifike te nje natyre te vecante. Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e pjesëve te nderrimit qe do te nevojiten të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

2.3.7. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015/ose/ ekuivalent, objekti i së cilës t'i përkasë fushës së aktivitetit të OE. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, ku percaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter eshte ne perputhje dhe me piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”. Gjithashtu ISO 9001: 2015 perfaqeson standartin nderkombetar unanim i njohur si standarti qe i perket kerkesave per nje sistem manaxhimi te cilesise , specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, për një organizatë e cila duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve dhe të zbatueshme ligjore dhe rregullatore, dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e klientit përmes zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e përpunueshmërisë me kërkesat e konsumatorëve dhe kërkesat ligjore dhe rregullative). Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia, ose produktet dhe shërbimet që ofron. Ne rastin aktual eshte vendosur konform objektit te prokurimit.

2.3.8. Planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollat që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera percaktohet se . 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. ne rastin actual plani I veprimit nisur dhe nga eksperienca e meparshme sherben si tregues i kapaciteteve teknike dhe profesionale te OE te interesuar per kete procedure prokurimi dhe ne menyre qe te mos krijoje konfuzion ne zbatimin e kontrates.

SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE TERMAT E REFERENCES PER PROCEDUREN " MIREMBAJTJE FULL RISK E PAJISJEVE MJEKESORE, CT SCANER DHE MAMOGRAFI"

jane percaktuar nga specialisti i fushes me shkrese nr.2623.prot date 18.07.2023, nuk jane diskriminuese dhe jane ne perputhje me legjislacionin aktual ne fuqi si dhe jane kushte minimale per tu plotesuar nga operatoret ekonomik

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOT. 1 – “MIREMBAJTJE FULL RISK E PAJISJES MJEKESORE, CT SCANER”

Lloji i aparatures CT-Skaner, prodhues Philips, model MX16

Shërbimet që duhet të ofrohen: *Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesve përkatës të pajisjeve mjekësore që janë në përdorim në Spitalin Rajonal Fier sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit.*

Shërbimet që duhet të ofrohen:

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të pajisjes, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjes.

Mirëmbajtja korrigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimin.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjet përkatëse.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korrigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjet dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontrolleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.

Të gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit të mëposhtme janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës:

- Tubi i rezeve X (blerja dhe instalimi i saj në rast dëmtimi) për pajisjet përkatëse
- Gjeneratori

- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimit, të nevojshme për funksionimin sipas standardeve.
- Pajisja UPS i pajisjeve
- Të gjitha pjesët e tjera të këmbimi që mund të lindë nevoja të zëvendësohen kur difektohen, me qëllim mirëfunksionimin e pajisjes.

I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitetin me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve:

Personeli teknik i të Kontraktuarit do të garantojë mbulimin e shërbimit për 52 javë në vit, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia dhe shpeshësia e ndërhyrjeve.

I Kontraktuari duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I Kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda 24 orëve në pajisjet e instaluar lidhur me defektet e konstatuara.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, i Kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Kjo mund të aplikohet në rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve apo shtimit të pajisjeve të reja për shkak të përfundimit të periudhës së garancisë. Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës. Vlera e zvogëluar ose shtuar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisjeje.

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjen do të jetë Full Risk ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korrigjuese për të gjithë difektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajta full risk duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjeve, vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure, janë pajisje shumë komplekse. Përdorimi i pajisjes kërkon staf të kualifikuar e certifikuar nga prodhuesi. Riparimi i pajisjes duhet të kryhet vetëm nga specialistë të kualifikuar dhe të trajnuar posaçërisht për pajisjen, pranë prodhuesve respektive si dhe të autorizuar prej tyre, për shkak jo vetëm të kompleksitetit por edhe të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin për shëndetin e njerëzve.

Duhet marrë gjithmonë masat për zëvendësimin në kohë të saj si dhe pjesëve të këmbimit me qëllim mosndërprerjen e funksionimit të shërbimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR PROCEDURËN LOT. 2 - "MIREMBAJTJE FULL RISK E PAJISJES MJEKËSORE MAMOGRAFI"

Lloji i aparatures Mamografi model : Soul, prodhues: Medi-Future

Shërbimet që duhet të ofrohen: ***Mirëmbajtja full risk sipas rekomandimeve të prodhuesit përkatës të pajisjes mjekësore Mamografi Soul, që është në përdorim në Spitalin Rajonal Fier sipas përshkrimit të më poshtëm të shërbimit.***

Shërbimet që duhet të ofrohen:

Mirëmbajtja parandaluese: ky shërbim duhet të kryhet periodikisht sipas rekomandimeve të prodhuesit, me qëllim parandalimin e defekteve që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur sistemin e pajisjes në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të pajisjes, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetrimi apo përkeqësimi i performancës së pajisjes.

✓ **Shërbime Paraprake**

Kontrolli i parametrave backup SOUL

✓ **Inspektimi**

Inspektimi paraprak vizual i vendit

Inspektimi vizual i pajisjes

Inspektimi i ekranit të rrezatimit

✓ **Gantry**

Kontrolli i temperaturës së detektorit

Kontrolli i matjes së trashësisë së gjoksit

Kontrolli i mekanizmave të gantry

Kontrolli i kapakëve të gantry

Kontrolli i butonave të ndalimit të urgjencës së gantry

✓ **UPS**

Kontrolli i funksionimit të UPS

✓ **Kontrolli i Cilësisë (Quality Control)**

Kontrolli i ACR nëpërmjet fantomës së imazhit

Kontrolli i forcës maksimale të ngjeshjes

Refuzimi i analizës

✓ **Stacioni i punës (Workstation)**

Kontrolli i monitorëve dhe tastierës

Kontrolli dhe heqja e skedarëve bazë dhe log

Kontrolli i cilësisë së monitorit RWS

Mirëmbajtja korigjuese: Ky shërbim do të përfshijë përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionim, identifikimin e shkaqeve, eliminimin e shkaqeve dhe defekteve dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, verifikimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe në kontrollin e sigurisë sipas rekomandimeve të prodhuesit. Ky shërbim do të përfshijë edhe lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin e pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes dhe kalibrimit.

Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisjur me autorizimin e prodhuesit për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes për pajisjen përkatëse.

Ndërhyrjet duhet të synojnë nxjerrjen në pah të të gjitha situatave të rrezikut të mundshëm dhe të identifikojnë veprimet korigjuese me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së spitalit, duke marrë parasysh kushtet specifike mjedisore dhe operative në të cilat ato operojnë me pajisjen dhe karakteristikat individuale të projektimit dhe ndërtimit të tyre, duke iu referuar periudhës së vendosjes së tyre në treg. Në lidhje me çdo mospërputhje të zbuluar gjatë zbatimit të kontroleve dhe sipas nivelit të rrezikut të identifikuar, i Kontraktuari do të paraqesë raport të hollësishëm teknik tek Kontraktuesi.

Ndërhyrjet e nevojshme do të sigurojnë eliminimin e të gjitha mos konformiteteve të konstatuara në pajisje dhe pjesën e furnizimit të burimit të ushqimit. Këto ndërhyrje janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

Përveç afateve të përcaktuara në kalendarin e verifikimit periodik, shërbimi i verifikimit të sigurisë së përmendura në këtë pikë duhet të parashikohet edhe pas mirëmbajtjes korigjuese, kur është e zbatueshme.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta.

Ofertuesi duhet të lëshojë një deklaratë që merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në spital dhe se spitali nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të kompanisë në ambientet e tij.

Pjesët përbërëse të sistemit, të këmbimit, përdorimit dhe konsumit.

Të gjitha pjesët e këmbimit dhe konsumit janë në ngarkim të të Kontraktuarit dhe përfshihen në vlerën e kontratës.

I Kontraktuari duhet të parashikojë blerjen dhe zëvendësimin e të gjitha pjesëve dhe materialeve të këmbimit gjatë kryerjes së shërbimeve me shpenzimet e tij. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, në përputhje me legjislacionin për pajisjet mjekësore duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen. Garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit.

Orari dhe vendet e kryerjes së shërbimeve:

Personeli teknik i të Kontraktuarit do të garantojë mbulimin e shërbimit për 52 javë në vit, me përjashtim të festave zyrtare, nga e hëna në të premte me orë 08:00-16:00 dhe të shtunën 8:00-14:00. Këto mund të jenë objekt ndryshimesh në varësi të nevojave specifike të Kontraktuesit.

I Kontraktuari do të sigurojë realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në kontratë edhe në rast greve apo konfliktesh sindikaliste apo ngjarje të tjera të parashikueshme.

I Kontraktuari do të caktojë një person kontakti për raportimin e defekteve dhe kontaktet të tjera.

I kontraktuar duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes në rastet e emergjencave edhe gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve të diela.

Emri i personit të kontaktit të deklarohet në dokumentet e ofertës.

Shpejtësia dhe shpeshtësia e ndërhyrjeve.

I Kontraktuari duhet të regjistrojë çdo thirrje me qëllim gjurmimin e fillimit dhe mbarimit të çdo ndërhyrje.

Njoftimi për defektet do të kryhet me telefon dhe email.

I Kontraktuari do të sigurojë ndërhyrjen brenda 24 orëve në pajisjet e instaluar lidhur me defektet e konstatuara.

Kohëzgjatja maksimale e riparimit të defektit do të jetë jo më shumë se 24 orë kur pajisja nuk ka nevojë për pjesë këmbimi dhe 5 ditë zyrtare pune kur kërkohet zëvendësimi i pjesëve të këmbimit.

Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën, gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, i Kontraktuari nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Kjo mund të aplikohet në rastet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjes apo shtimit të një pajisje të re për shkak të përfundimit të periudhës së garancisë. Ky ndryshim do të rezultojë në rishikimin e kontratës. Vlera e zvogëluar ose shtuar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje. Vlera ditore do të llogaritet bazuar në vlerën vjetore të mirëmbajtjes së asaj pajisjeje.

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjen do të jetë Full Risk ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korigjuese për të gjithë difektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajta full risk duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjes, vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure, janë pajisje shumë komplekse. Përdorimi i pajisjes kërkon staf të kualifikuar e çertifikuar nga prodhuesi. Riparimi i këtyre pajisjeve duhet të kryhet vetëm nga specialistë të

kualifikuar dhe të trajnuar posaçërisht për pajisjen, pranë prodhuesve respektive si dhe të autorizuar prej tyre, për shkak jo vetëm të kompleksitetit por edhe të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin për shëndetin e njerëzve. Duhet marrë gjithmonë masat për zëvendësimin në kohë të saj si dhe pjesëve të këmbimit me qëllim mosndërprerjen e funksionimit të shërbimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike Specifikimet teknike per te dy lotet jane hartuar ne përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Pershkrimi i sakte i aparatures duke perfshire dhe marken eshte vendosur pasi ne rastin aktual kemi te bejme me nje aparature specifike dhe per te realizuar objektin e prokurimit eshte e domosdoshme vendosja e te dhenave te aparatures perfshi dhe marken e saj konform Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 36 “**Specifikimet teknike**” pika 1. si dhe pika 4 ku citohet se 4. *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”* pasi ne rastin aktual nuk ka mundësi tjetër përshkrimi të aparatures për të cilën kërkohej të realizohej procedura object prokurimi

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Lot. 1 – “Mirëmbajtje full risk e pajisjes mjekësore, CT Scanner” (model MX16 prodhues Philips),

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjen do të jetë Full Risk ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korrigjuese për të gjithë difektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajta full risk duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjes, vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure, janë pajisje shumë komplekse. Përdorimi i pajisjes kërkon staf të kualifikuar e çertifikuar nga prodhuesi. Riparimi i këtyre pajisjeve duhet të kryhet vetëm nga specialistë të kualifikuar dhe të trajnuar posaçërisht për pajisjen, pranë prodhuesve respektive si dhe të autorizuar prej tyre, për shkak jo vetëm të kompleksitetit por edhe të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin për shëndetin e njerëzve.

Duhet marrë gjithmonë masat për zëvendësimin në kohë të saj si dhe pjesëve të këmbimit me qëllim mosndërprerjen e funksionimit të shërbimit.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Spitali Rajonal Fier

Lot. 2 - “Mirëmbajtje full risk e pajisjes mjekësore Mamografi” (loji i aparatures model : Soul, prodhues: Medi-Future)

Shërbimi i mirëmbajtjes për pajisjen do të jetë Full Risk ku ofruesi i shërbimit merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes parandaluese si dhe korrigjuese për të gjithë difektet që mund të ndodhin përfshirë edhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit.

Mirëmbajta full risk duhet të përfshijë shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese, riparuese dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit. Kjo kontratë duhet të garantojë performancë të punës së pajisjes, vazhdimësinë e punës së tyre duke ofruar shërbim pa ndërprerje për pacientët duke mundësuar shfrytëzimin eficient të këtyre pajisjeve.

Pajisjet mjekësore objekt i kësaj procedure, janë pajisje shumë komplekse. Përdorimi i pajisjes kërkon staf të kualifikuar e çertifikuar nga prodhuesi. Riparimi i këtyre pajisjeve duhet të kryhet vetëm nga specialistë të

kualifikuar dhe të trajnuar posaçërisht për pajisjen, pranë prodhuesve respektive si dhe të autorizuar prej tyre, për shkak jo vetëm të kompleksitetit por edhe të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin për shëndetin e njerëzve. Duhet marrë gjithmonë masat për zëvendësimin në kohë të saj si dhe pjesëve të këmbimit me qëllim mos ndërprerjen e funksionimit të shërbimit.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Spitali Rajonal Fier

(Termat e references janë hartuar konform nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citohet Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. Në rastin aktual termat e references janë të qarta dhe përcaktojnë saktë mënyrën e kryerjes së shërbimit të kërkuar).

2. Afati i fundit për pranimin e dokumentave dhe data e zhvillimit të tenderit, do të jetë data 01.08.2023 ora 10.⁰⁰. Vendi www.app.gov.al; Spitali Rajonal Fier.

(Mbeshtetur në pikën 3 të nenit 49 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” “3. Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës.” si dhe duke pasur parasysh se shpallja e njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-se bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes në sistem të njoftimit, afati i vendosur nga NjP është brenda afatit ligjor përkatës).